



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:117043
Datë: 05.05.2021
Numri i dokumentit: 01758979

P.nr.1000/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË / Departamenti i përgjithshëm – Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Adnan Kamberi, në çështjen penale kundër të pandehurit M.B.për shkak të veprës penale Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par. 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë / Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 6937/15 të datës 27.02.2018, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit gjyqësor, verbal dhe publik me datë 15.04.2021, në prani të Prokurorit të Shtetit Hava Krasniqi, të dëmtuarit K. S., të pandehurit M.B.dhe V. H., më datë 15.04.2021 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 05.05.2021, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit:

M.B., i biri i H. dhe nënës S. e gjinisë M., i lindur më, me vendbanim në fshatin Sh., KK M., i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Mbështetur në nenin 363 par. 1, nënpar. 1.1 të KPP-së:

REFUZOHET AKUZA

Sepse:

Me datë 28.11.2015, rreth orës 15.40, në Prishtinë, në rrugën e “UÇK-së”, te selia e lëvizjes Vetevendosje, i pandehuri ka sulmuar policët me mjete të ndryshme si karrige, drunj, orendi dhe gjësende tjera pasi që policia kishte shkuar në selinë e kësaj Lëvizje sipas urdhërit të Gjykatës Themelore në Prishtinë për arrestimin e deputetit A. K..

- Me çka kishte për të kryer veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par. 1 të KPRK-së.
- Prokurori i Shtetit është tërhequr nga aktakuza në shqyrtim gjyqësor.
- Shpenzimet e procedurës penale bien ne barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.
- Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën me numër PP.II.nr. 6937/15 të datës 27.02.2018, kundër të pandehurit M. B., për shkak të veprës penale Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform dispozitave të KPP-së, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor në prezencë të Prokurorit të Shtetit dhe të pandehurve M.B.dhe V. H. si dhe të dëmtuarit K. S.. Në shqyrtim gjyqësor i dëmtuari K. S. i ka propozuar gjykatës që lidhur me veprën penale sulmi nga neni 187 par. 1 të KPP-së, të referohet në procedurën e ndërmjetësimit, lidhur me propozimin e të dëmtuarit që vepra penale Sulmi nga neni 187 par. 1 të KPP-së, të referohet në procedurën e ndërmjetësimit, të pandehurit M.B.dhe V. H.deklaruan se pajtohen me propozimin, gjithashtu edhe Prokurorja e Shtetit deklarojë se pajtohet me propozimin që të pandehurit M.B.dhe V. H. si dhe i dëmtuari K. S. lidhur me veprën penale Sulmi nga neni 187 par. 1 të KPRK-së, të referohet në procedurën e ndërmjetësimit. Kurse për veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par. 1 të KPRK-së, Prokuroria e Shtetit në shqyrtim gjyqësor deklarojë se tërhiqet nga ndjekja penale për këtë veprë penale.

Gjykata duke pasur parasysh propozimin dhe pëlqimin e palëve që për veprën penale Sulmi nga neni 187 par. 1 të KPRK-së, të referohet në procedurën e ndërmjetësimit, si dhe pasi që Prokurorja e Shtetit u tërhoq nga ndjekja penale kundër të pandehurit M.B.për veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par. 1 të KPRK-së. Gjykata pasi që morri mendimin e të gjitha palëve në procedurë bëri veqimin e procedurës penale kundër të pandehurve M.B.dhe V. H. për veprën penale sulmi nga neni 187 par. 1 të KPRK-së, dhe të njëjtën çështje penale pas marrjes së pëlqimit nga të gjitha palët e referojë në procedurën e ndërmjetësimit.

Ndërsa, lidhur me veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par. 1 të KPRK-së, kundër të pandehurit M. B., pasi që prokurorja e shtetit u tërhoq nga ndjekja penale në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata mbështetur në nenin 363 par. 1, nënpar. 1.1 të KPP-së, refuzojë aktakuzën numër PP.II.nr. 6937/15 të datës 27.02.2018.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Nga ajo çfarë u tha me lart, në bazë të nenit 410 par. 1, të KPRK-së, 363 par. 1, nënpar. 1.1, 453 par. 4 të KPP-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.1000/18; datë 05.05.2021

G j y q t a r i
Adnan Kamberi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar e drejta e ankesës në afatin prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën.